

**LIGJ**  
**Nr.7664, datë 21.1.1993**

**PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TE PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Mbrojtja e mjedisit përbën një kusht themelor për sigurimin e zhvillimit të shoqërisë dhe një përparësi kombëtare dhe ka këto elemente kryesore strategjike: parandalimin dhe uljen e ndotjes së ujit, të ajrit, tokës dhe të ndotjeve të tjera të çfarëdolloji, ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike sipas bazës natyrore bio-gjeografike të vendit, shfrytëzimin racional të burimeve natyrore dhe shmangien e mbishfrytëzimit të tyre;

riaftësimin ekologjik të zonave të dëmtuara nga veprimtaria njerëzore ose fenomenet natyrore shkatërruese si dhe ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

**Neni 2**

Në kuptim të këtij ligji:

a) "Mjedisi" është tërësia e elementeve dhe e faktorëve natyrorë dhe njerëzorë me veprimet dhe bashkëveprimet e tyre.

Elementet, fenomenet dhe produktet përfaqësohen nga uji, ajri, toka dhe nëntoka, rrezatimi diellor, organizmat bimorë e shtazorë, si dhe të gjitha proceset dhe fenomenet natyrore që rrjedhin nga bashkëveprimi i tyre e që kushtëzojnë jetën.

Faktorët njerëzorë përfaqësohen nga qenia e shoqërisë njerëzore dhe veprimtaria e saj ekonomike e sociale.

b) "Mbrojtja e mjedisit" është veprimtaria që synon parandalimin e degradimit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit.

c) "Ndotja e mjedisit" është ndryshimi i cilësisë së tij, si pasojë e krijimit dhe e futjes së faktorëve fizikë e kimikë ose biologjikë të burimeve natyrore ose njerëzore nga brenda ose jashtë vendit.

ç) "Dëmtimi i mjedisit" është prishja e karakteristikave fiziko-kimike dhe strukturore të ekosistemit natyror, ulja e prodhimit biologjik dhe e shumëllojshmërisë së ekosistemeve natyrore e njerëzore, prishja e ekuilibrit ekologjik dhe e cilësisë së jetës, e shkaktuar kryesisht nga ndotja e ujit, ajrit, tokës dhe katastrofat.

d) "Lëndë të rrezikshme" janë lëndët, prodhimi, transporti, ruajtja, përdorimi ose shkarkimi i të cilave në mjedis, si pasojë e vetive të tyre, dëmtojnë ose mund të dëmtojnë shëndetin e njeriut, cilësitë e mjedisit, florën, faunën, biocenozat dhe biotipet.

dh) "Mbetje të rrezikshme" janë lëndët toksike gërryese, ngacmuese, shpërthyes, të përflakshme, kancerogjene dhe radioaktive, të afta për të shkaktuar ndryshimin ose krijimin e një lënde tjetër, duke pasur edhe cilësinë për të shpejtuar djegjen e për të prishur gjendjen natyrore të ujit, tokës e ajrit, duke dëmtuar njeriun e të gjitha qëniet e gjalla në mjedisin natyror.

e) "Personat juridikë e fizikë" janë ndërmarrjet, institucionet, shoqëritë, organizatat dhe individët vendas e të huaj, shtetërorë e privatë, që kryejnë veprimtari prodhimi, ndërtimi, shërbimi dhe çdo veprimtari tjetër me karakter ekonomik e social që mund të shkaktojnë ndotje ose dëmtim të

mjedisit.

### Neni 3

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi me lëndë të gazta, të lëngëta, të ngurta, radioaktive, lëndë dhe mbetje të rrezikshme që krijohen ose shkarkohen nga objekte dhe veprimtari industriale, bujqësore, komunale, tregtare, socialkulturore, ushtarake, të transportit dhe nga veprimtaritë e çfarëdollojshme, që çenojnë ekuilibrin e sistemeve ekologjike natyrore ose dëmtojnë të mira materiale dhe vlerat kulturore historike, është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore dhe për personat juridikë e fizikë, vendas e të huaj.

### Neni 4

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi përfshin mbrojtjen e ekosistemeve ujore, të atmosferës, të ekosistemeve të tokës dhe të natyrës së peisazhit.

Rregulla të hollësishme për mbrojtjen e ujit, ajrit, tokës, natyrës e peisazhit caktohen me dispozita të veçanta ligjore.

### Neni 5

Në Republikën e Shqipërisë ndalohet importimi i mbetjeve dhe i lëndëve të rrezikshme me qëllim ruajtje, depozitimi apo asgjësimi.

Transportimi tranzit i mbetjeve dhe i lëndëve të rrezikshme përmes territorit dhe ujërave territoriale e të brendshme të Republikës së Shqipërisë lejohet vetëm nëse parashikohet në një akt ndërkombëtar, në të cilin Republika e Shqipërisë është palë.

Në kato raste transporti tranzit bëhet me leje të Këshillit të Ministrave në përputhje me rregullat e sigurimit të përcaktuara prej tij.

### Neni 6

Republika e Shqipërisë zbaton parimet dhe normat e konventave, të marrëveshjeve e traktateve ndërkombëtare për mjedisin, në të cilat është palë, kurse kur nuk është palë, ajo merr parasysh, njeh e respekton parimet dhe normat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare për mjedisin.

## KREU II VLERËSIMI I NDIKIMIT NDAJ MJEDISIT

### Neni 7

Objekte të vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit janë të gjitha veprimtaritë e personave juridikë e fizikë vendas e të huaj, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### Neni 8

Vlerësimi i ndikimit ndaj mjedisit bëhet mbi:

- a) Programet dhe planet kombëtare e lokale të strukturimit të territorit dhe zhvillimit qytetar, si dhe ndryshimet e tyre.
- b) Projektet dhe veprimtaritë që kenë efekte të rëndësishme mbi mjedisin, ose që janë veçanërisht të rrezikshme për shëndetin e njeriut.
- c) Projektet për rindërtim e zgjerim të veprimtarive të përcaktuara në shkronjën "b" të këtij neni.
- ç) Projektet dhe veprimtaritë lokale sipas gjykimit dhe përcaktimit të organeve të pushtetit lokal.

## Neni 9

Organet kompetente që kërkojnë vlerësim të ndikimit ndaj mjedisit, sipas këtij ligji, janë Komiteti për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit, agjencitë e tij rajonale dhe këshillat e komunave, bashkive e rretheve, sipas njësive territoriale përkatëse.

Ekspertët ose institucionet për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit caktohen për çdo rast vlerësimi nga organet e sipërpërmendura. Për punën e kryer ata shpërblehen sipas rregullave të caktuara nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit.

## Neni 10

Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit bën vlerësimin e projekteve dhe veprimtarive sipas shkronjave "a", "b" dhe "c" të nenit 8 të këtij ligji, të cilat kanë ndikim ndaj mjedisit.

Rivlerësimi kryhet periodikisht me urdhër të Kryetarit të Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit, por jo më rrallë se një herë në 5 vjet.

Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit mund të kërkojë nga organet e pushtetit lokal, kur e shoh të domosdoshme, kryerjen e rivlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit për projekte e veprimtari lokale.

## Neni 11

Rregullat dhe procedurat e vlerësimit të gjendjes së mjedisit dhe ndikimit të veprimtarisë së personave juridikë e fizikë ndaj tij miratohen nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit me propozim të Komitetit të Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse.

## Neni 12

Personat juridikë e fizikë të interesuar kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e përcaktimit të rezultateve të vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit.

Ata informohen nga mjetet e informacioni publik kombëtar ose lokal, ose mjete të tjera të përshtatshme për procedurën e vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit, të paktën një muaj para fillimit të saj.

## Neni 13

Vlerësimi i ndikimit ndaj mjedisit, kryhet me ekspertë ose institucione vendase a të huaja të fushave përkatëse, të cilët:

- a) Kanë kompetencë profesionale.
- b) Janë të pavarur dhe nuk kanë lidhje kontraktuese me investitorët dhe zbatuesit e projektit, si dhe me veprimtarinë përkatëse.
- c) Japin përfundime në përputhje me procedurën e caktuar të vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit dhe normat e standartet e lejuara për ndotjen e mjedisit.

## Neni 14

Personat juridikë e fizikë dhe autorët e projekteve të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji, për fillimin e vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit, janë të detyruar të paraqesin dokumente që përfshijnë:

- a) Përshkrimin e projektimit ose të veprimtarisë dhe projektin, si dhe vendin e madhësisë së tyre.
- b) Përshkrimin e mjedisit, me të cilin lidhet projekti ose veprimtaria para zbatimit të tyre.
- c) Parashikimin e ndikimit ndaj mjedisit.
- ç) Përshkrimi i masave që do të merren për parandalimin ose ndalimin e efekteve negative ndaj mjedisit.
- d) Personat juridikë e fizikë që mund të ndikohen nga ndotja ose dëmtimi i mjedisit.
- dh) Përfundime.

e) Dokumente të tjera që gjykohen të nevojshme nga Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit.

#### Neni 15

Organi kompetent sipas këtij ligji, mbi bazën e përfundimeve të ekspertëve ose institucioneve, vendos për vlerësimin e kryer të ndikimit ndaj mjedisit, duke marrë këto masa:

a) Mbylljen, ndalimin ose ndërprerjen e plotë a të pjesshme të veprimtarisë së personave juridikë ose fizikë dhe të zbatimit të projekteve, kur ndikimi ndaj mjedisit është negativ.

b) Ndalimin e vazhdimin të mëtejshëm të procedurës së vlerësimit për mungesë të ndikimit negativ ndaj mjedisit.

Organi kompetent ua bën të njohura vendimet e tij palëve të interesuara dhe, sipas rastit jep informacion publik.

#### Neni 16

Shpenzimet e vlerësimit, kur ndikimi ndaj mjedisit është negativ, përballohen nga personi juridik ose fizik, autor i ndotjes ose dëmtimit të mjedisit. Urdhri për arkëtimin e shpenzimeve të vlerësimit, i lëshuar nga organi përkatës kompetent, është titull ekzekutiv.

### KREU III

#### LEJET (LICENCAT) PËR VEPRIMTARITË QË NDIKOJNË NDAJ MJEDISIT

#### Neni 17

Personat juridikë e fizikë, për kryerjen e veprimtarive ekonomike e sociale që ndikojnë ose mund të ndikojnë ndaj mjedisit, janë të detyruar të marrin leje nga organet ompetente të caktuara në këtë ligj.

#### Neni 18

Lejet e mjedisit jepen për këto veprimtari ekonomike e sociale:

a) Ndërtimi dhe vënia në punë e veprave të ndryshme me interes kombëtar a lokal.

b) Programet dhe planet kombëtare e lokale të strukturimit të territorit dhe zhvillimi qytetor, si dhe ndryshimet e tyre.

c) Ndërtimin e rrugëve, hekurudhave e porteve detare, veprimtaritë industriale, objektet hidroteknike, bonifikimi i tokave dhe projektet e përmirësimit të rrjedhjes së ujit në sipërfaqe.

ç) Kërkimi, nxjerrja dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore të tokës e nëntokës.

d) Shfrytëzimi i burimeve minerare e biologjike të ujrave me interes peshkimi, duke pasur parasysh speciet, periudhat, mjetet dhe nivelet e lejuara të peshkimit.

dh) Shfrytëzimi i pyjeve me interes të përgjithshëm, ngritja e plantacioneve pyjore, gjuetia, duke pasur parasysh zonat, speciet, periudhat, mjetet dhe nivelet e lejuara për gjueti.

e) Shfrytëzimi i burimeve natyrore të florës dhe faunës të zonave të ndryshme si dhe të fundeve detare.

ë) Hapja e plantacioneve të reja për rritjen e frutave.

f) Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i produkteve toksike dhe i atyre me përdorim fitosanitar, bujqësor e pylltarie.

g) Importimi dhe eksportimi i lëndëve toksike dhe transportimi i tyre tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

gj) Përcaktimi i mënyrës së transportimit dhe i vendit për depozitimin, përmirësimin dhe asgjësimin e lëndëve dhe njeturave toksike.

h) Importimi dhe eksportimi i bimëve dhe i kafshëve që mund të dëmtojnë florën e faunën.

i) Veprimtari të tjera që mund të ndikojnë ndaj mjedisit dhe që përcaktohen nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit.

#### Neni 19

Lejet e mjedisit, sipas nenit 18 të këtij ligji, jepen nga këto organe:

- a) Për veprimtaritë e shkronjave "g" dhe "gj" nga Këshilli i Ministrave.
- b) Për veprimtaritë me interes kombëtar dhe veprimtaritë e tjera të parashikuara në shkronjat "a" deri në "f" dhe në shkronjën "h" nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit.
- c) Për veprimtaritë me interes lokal të parashikuar në shkronjat "a" deri në "c", në shkronjat "d" dhe "dh" nga këshillat e komunave, bashkive ose rretheve sipas njësive territoriale përkatëse.
- d) Kompetencat sipas shkronjës "i" përcaktohen nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit.

#### Neni 20

Leja e mjedisit jepet me kërkesën e personit juridik e fizik mbi bazën e dokumentacionit teknik dhe studimit e analizës për ndikim ndaj mjedisit të paraqitura prej tij. Ajo jepet brenda 3 muajve nga paraqitja e kërkesës dhe është e vlefshme që nga koha kur fillon veprimtaria e saj deri sa kushtet, mbi të cilat është dhënë, nuk ndryshojnë.

Organet përkatëse kompetente mund të zgjatin kohën e dhënies së lejes deri në 6 muaj, kur nuk plotësohen kushtet sipas paragrafit të parë të këtij neni. Këto organe janë të detyruara të japin përgjigje brenda afatit të mësipërm. Në të kundërt leja quhet e miratuar.

Leja e mjedisit bëhet e pavlefshme nëse veprimtaria nuk fillon brenda një viti nga lëshimi i saj. Me kalimin e këtij afati mund të kërkohet leje e re.

#### Neni 21

Organet që kanë dhënë lejen e mjedisit, mund të rishikojnë a të heqin lejen nëse shfaqen elemente të reja ekologjike të panjohura në kohën e dhënies së saj, ose nëse dalin dispozita të reja për mjedisin. Për rishikimin ose heqjen e lejes Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit, në bashkëpunim me ministrinë e institucionet e tjera qendrore, duke marrë parasysh natyrën e veprimtarisë, cakton afate, brenda të cilave duhet të plotësohen kushtet e mësipërme për lejen e mjedisit.

#### Neni 22

Për veprimtari me rëndësi dhe ndikim të veçantë ndaj mjedisit, heqja e lejes dhe mbyllja e tyre bëhet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit.

Veprimtaritë me rëndësi dhe ndikim të veçantë ndaj mjedisit përcaktohen nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit, në bashkëpunim me ministrinë e institucionet e tjera përkatëse, dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 23

Përcaktimi i studimeve dhe i analizave për ndikim ndaj mjedisit, që paraqesin personat juridikë e fizikë për marrjen e lejes së mjedisit, dhe miratimi i procedurës së dhënies së lejes nga organet përkatëse kompetente bëhet nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit.

#### Neni 24

Veprimtaritë ekonomike e sociale të personave juridikë e fizikë të caktuar në nenin 18 të këtij ligji, kur kryhen pa lejen e mjedisit, sipas rastit mbyllen, ndalohen ose ndërpriten plotësisht a pjesërisht nga organet përkatëse kompetente.

Personat juridikë e fizikë, për veprimtaritë ekzistuese që nuk i plotësojnë kushtet për lejen e mjedisit sipas dispozitave të këtij ligji, janë të detyruar t'i plotësojnë këto kushte brenda afateve të caktuara nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit, në bashkëpunim me ministrinë e institucionet e tjera qendrore.

Veprimtaritë ekzistuese që nuk plotësojnë kushtet për lejet e mjedisit brenda afateve të caktuara, sipas rastit, mbyllen, ndalohen ose ndërpriten plotësisht a pjesërisht nga organet e mësipërme.

#### Neni 25

Personat juridikë e fizikë që pajisen me lejen e mjedisit, paguajnë një tarifë shërbimi që caktohet nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit, dhe derdhet në llogarinë e organit që e ka dhënë lejen.

Personat juridikë e fizikë që investojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, përjashtohen nga tarifa e shërbimit. Këto investime përcaktohen nga Komiteti për Mbrojtjen e mjedisit, në bashkëpunim me ministrinë e tjera përkatëse.

### KREU IV KONTROLLI DHE INFORMACIONI PËR GJENDJEN E MJEDISIT

#### Neni 26

Kontrolli për gjendjen e mjedisit qëndron në mbikëqyrjen e elementeve e të faktorëve natyrorë e njerëzorë të mjedisit, në vëzhgimin dhe regjistrimin e tyre, si dhe në mbikëqyrjen e burimeve e të shkaqeve të këtyre ndryshimeve.

Të dhënat e mbledhura nga kontrolli shërbejnë si bazë për informacionin e gjendjes së mjedisit, për rishikimin ose heqjen e lejeve të mjedisit dhe për marrjen e masave të tjera përkatëse të përcaktuara në këtë ligj.

#### Neni 27

Kontrolli për gjendjen e mjedisit është detyrë e punonjësve të caktuar nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit, Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe agjencitë e tij rajonale, ministrinë e institucionet e tjera qendrore dhe këshillat e komunave, bashkive ose rretheve, sipas njësive territoriale përkatëse.

Kontrolli ushtrohet në mënyrë të përhershme e të vazhdueshme, në përputhje me përmasat dhe burimet e shkaqet e ndotjes ose të dëmtimit të mjedisit.

#### Neni 28

Përmasat e veçanta të mjedisit, objektet e kontrollit dhe metodika e ushtrimit të kontrollit miratohen nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit.

#### Neni 29

Kontrolli sipas burimeve e shkaqeve të ndotjes ose të dëmtimit të mjedisit ushtrohet:

- a) Me një akt të miratuar nga organet kompetente, të caktuara në nenin 27 të këtij ligji.
- b) Me kërkesë të personave juridikë e fizikë dhe të shtetasve të prekur a që mund të preken nga ndotja ose dëmtimi i mjedisit, si dhe të organizatave me karakter mjedisor.

#### Neni 30

Shpenzimet e kontrollit për gjendjen e mjedisit, kur verifikohet ndotja ose dëmtimi i mjedisit, përballohen nga personi juridik e fizik, autor i ndotjes ose dëmtimit të mjedisit. Urdhri për arkëtimin e shpenzimeve të kontrollit, i lëshuar nga organi përkatës kompetent, është titull ekzekutiv.

#### Neni 31

Organi kompetent, mbi bazën e kontrollit të ushtruar për gjendjen e mjedisit, vendos, sipas rastit, për mbylljen, ndalimin a ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të veprimtarisë së personave juridikë a fizikë që kanë shkaktuar ndotje ose dëmtim të mjedisit, duke caktuar edhe detyrat përkatëse për rregullimin e gjendjes.

## Neni 32

Informacioni për gjendjen e mjedisit përfshin:

- a) Të dhëna për gjendjen e elementeve e faktorëve të mjedisit.
  - b) Të dhëna për rezultatet e veprimeve që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë ndotje a dëmtim të mjedisit dhe elementeve a faktorëve të tij.
  - c) Të dhëna për veprimtaritë e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit.
  - d) Të dhëna për gjendjen dhe shfrytëzimin e burimeve biologjike dhe minerare.
- Informacioni shoqërohet me shpjegime rreth pasojave negative të mundshme me veprim të vonuar mbi mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe me rekomandime për mënyrën e veprimit të shtetasve në raste të parashikimit të pasojave negative.

## Neni 33

Informacioni për gjendjen e mjedisit, i paraqitur nga institucionet e specializuara, merret e grumbullohet nga Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe agjencitë e tij rajonale, ministrinë e institucionet e tjera qendrore dhe këshillat e komunave, bashkive ose rretheve, sipas njësive territoriale përkatëse.

Personat juridikë e fizikë janë të detyruar të paraqesin informacionin për shkarkimet sasiore e cilësore të lëndëve që ndikojnë në mjedis, brenda dy javëve nga paraqitja e kërkesës.

Informacioni paraqitet në organet dhe sipas rregullave të caktuara nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit.

## Neni 34

Organet e caktuara në nenin 33 të këtij ligji publikojnë nëpërmjet mjeteve të informimit publik ose mjeteve të tjera të përshtatshme, në një formë të kuptueshme për shtetasit, informacionin që përmban të dhëna për ndryshimin e gjendjes së mjedisit.

Informacioni që përmban të dhëna me karakter sekret, të përcaktuar me dispozita të veçanta, paraqitet në formë të shkruar pa të drejtë përhapjeje.

## Neni 35

Organet e caktuara në nenin 33 të këtij ligji dhe personat juridikë e fizikë, sapo vërejnë ndotje ose dëmtim të mjedisit, janë të detyruar të informojnë popullsinë për ndryshimet mjedisore negative të ndodhura, masat e marra për kufizimin ose mënjanimin e tyre dhe kërkesat për mënyrën e veprimit të shtetasve për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e tyre.

## Neni 36

Personat juridikë e fizikë informojnë blerësit ose konsumatorët në kohën e shitjes a të kryerjes së shërbimit, me shkrim a me gojë, për komponentët e mallrave e të shërbimeve që janë të rrezikshme, dhe për efektet ose ndikimet negative të mundshme për mjedisin a shëndetin.

## KREU V DETYRAT DHE TË DREJTAT E ORGANEVE QËNDRORE E LOKALE PËR MJEDISIN

## Neni 37

Ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit zbaton e zhvillon politikën e qeverisë në fushën e mjedisit, me qëllim që të sigurohet një zhvillim ekonomik e social i harmonizuar me mjedisin dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës. Kjo politikë do të zbatohet përmes Komitetit të Mbrojtjes së Mjedisit.

## Neni 38

Ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit ushtron këto kompetenca kryesore në fushën e mjedisit:

a) I paraqet qeverisë strategjinë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, bashkërendon funksionet kontrolluese të ministrive, institucioneve të tjera qendrore dhe organeve të pushtetit lokal, si dhe miraton përmasat e veçanta të mjedisit dhe subjektet e kontrollit.

b) Përgatit raportin vjetor për gjendjen e mjedisit dhe ia paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave.

Këshilli i Ministrave, pas shqyrtimit të raportit, ia paraqet për miratim Kuvendit Popullor. Raporti i miratuar nga Kuvendi Popullor publikohet si raport vjetor për gjendjen e mjedisit.

c) Përpunon drejtimet kryesore dhe përcakton përparësitë e investimeve për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me zhvillimin ekonomik e social dhe mundësitë e vendit.

ç) Cakton dhe shpërndan fonde për punë kërkimore e shkencore, projekte e programe studimore për marrjen e masave të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit, për futjen e teknologjive ekologjikisht të pastra, sigurimin e aparaturave dhe kualifikimin e kuadrit brenda e jashtë vendit.

d) Përfaqëson vendin tonë në veprimtaritë ndërkombëtare, në organizatat ndërqeveritare e ndërshtetërore në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

dh) Në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse, miraton rregullore e udhëzime për regjistrimet e zonave me mjedis veçanërisht të rrezikuar dhe për projekte në përbërjen natyrore të mjedisit.

## Neni 39

Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit është organ qendror i specializuar në fushën e mjedisit në varësi të ministrit të Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit. Përbërja e Komitetit miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit, me propozim të kryetarit të Komitetit të Mbrojtjes së Mjedisit.

Komiteti ka agjencitë e tij rajonale që varen prej tij.

Detyrat dhe të drejtat e agjencive miratohen nga kryetari i Komitetit të Mbrojtjes së Mjedisit.

## Neni 40

Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit ka këto të drejta dhe detyra kryesore:

a) Ndjek zbatimin e ligjeve e të akteve të Këshillit të Ministrave për problemet e mbrojtjes së mjedisit dhe u paraqet organeve më të larta studime e propozime të ndryshme për organizimin, drejtimin dhe zgjidhjen e problemeve të mbrojtjes së mjedisit.

b) Ndihmon e kontrollon ministrinë e institucione të tjera qendrore, organet e pushtetit lokal dhe personat juridikë e fizikë për punën që bëjnë për zbatimin e dispozitave për mbrojtjen e mjedisit.

c) Përgatit projektet e marrëveshjeve, të konventave, protokolleve, projekteve e programeve që realizohen në kuadrin e bashkëpunimit dypalësh e shumëpalësh me organet përkatëse të tjera dhe organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit, si dhe ndjek zbatimin e tyre, kur ato përfundohen.

ç) Në bashkëpunim me ministrinë e institucionet e tjera qendrore dhe organet e pushtetit lokal, organizon monitorimin e ndotjeve industriale, qytetore, bujqësore e të lëndëve të rrezikshme, kimiko-toksike e radioaktive, propozon masa konkrete

për mbrojtjen e pastërtisë së ajrit, të ujit, tokës dhe të fondit gjenetik të vendit.

d) Studion nevojat e vendit për specialistë dhe bashkërendon punën e kualifikimit e të specailizimit të kuadrit për problemet e mbrojtjes së mjedisit.

dh) Organizon dhe mbështet edukimin dhe pjesëmarrjen e publikut në mbrojtjen e mjedisit. Organizon dhe ndjek botimet me karakter shkencor e popullor në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

e) Administron dhe shpërndan fonde të mjedisit të krijuara sipas ligjit dhe fonde për investime që parashikohen në buxhetin e shtetit për mjedisin.

ë) Në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse:

- Miraton kufijtë e lejueshëm të lëndëve ndotëse të gazta, të lëngëta, të ngurta e radioaktive që shkarkohen në ujë, ajër e tokë, si dhe kufijtë e lejueshëm të lëndëve të dëmshme e toksike që përmbahen në mbetjet e lëndët e rrezikshme.

- Miraton rregulla për grumbullimin, depozitimin, ruajtjen, transportimin dhe sistemimin e mbetjeve, lëndëve të rrezikshme e agentëve ndotës, si dhe për përdorimin e burimeve natyrore të përtëritshme e të papërtëritshme.

- Cakton listën e lëndëve që përmbajnë mbetjet dhe të lëndëve të rrezikshme.

#### Neni 41

Pranë Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit organizohet dhe funksionon Inspektoriati për Mbrojtjen e Mjedisit, i cili përbëhet nga kryeinspektori dhe inspektorët pranë komitetit, si dhe inspektorët pranë agjensive rajonale.

Detyrat, të drejtat dhe kompetencat e Inspektoriatit për Mbrojtjen e Mjedisit caktohen nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit.

Inspektoriati për mbrojtjen e mjedisit, për kryerjen e detyrave sipas këtij ligji, e bashkërendon punën me inspektoriatet e tjera dhe me organet e policisë.

#### Neni 42

Këshillat e komunave, të bashkive ose rretheve dhe njësitë përkatëse administrative ku veprojnë, kanë këto të drejta dhe detyra kryesore:

a) Të ndjekin zbatimin e ligjeve dhe të akteve të Këshillit të Ministrave për problemet e mbrojtjes së mjedisit.

b) Të marrin masa e të sigurojnë mbrojtjen dhe ripërtëritjen e mjedisit.

c) Të hartojnë e publikojnë programet dhe masat e tyre për mbrojtjen e mjedisit, të bashkërenduara me organet kompetente të specializuara për mjedisin.

ç) Të informojnë publikun për gjendjen e mjedisit dhe për veprimtaritë lokale të ndërmarra, subjekt i vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit.

d) Të ushtrojë kontroll për gjendjen e mjedisit sipas dispozitave të këtij ligji.

dh) Të administrojë dhe shpërndajë fondet lokale të mjedisit të krijuara sipas këtij ligji.

e) Të caktojnë vendet e depozitimit e të përpunimit të mbeturinave prodhuese dhe jetësore, në mënyrë që ato të mos e dëmtojnë mjedisin.

### KREU VI PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONET

#### Neni 43

Personat juridikë e fizikë që shkaktojnë dëme pasurore, të cilat rrjedhin nga ndotja a dëmtimi i mjedisit, detyrohen t'i zhdëmtojnë ato.

Ankesa për zhdëmtimin e dëmeve mund të paraqiten në gjykatë nga personat juridikë e fizikë të dëmtuar.

#### Neni 44

Zhdëmtimi i dëmeve të shkaktuara nga ndotja ose dëmtimi ndërkuftar i mjedisit bëhet në përputhje me konventat, marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare për mjedisin, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe, në rast se nuk është palë, kryhet në përputhje me normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit.

#### Neni 45

Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, kur nuk formojnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje

administrative në fushën e mjedisit:

a) Transportimi tranzit pa leje i mbetjeve dhe i lëndëve të rrezikshme përmes territorit dhe ujrave territoriale e të brendshme të Republikës së Shqipërisë.

b) Importimi i mbetjeve dhe i lëndëve të rrezikshme me qëllim ruajtjeje, depozitimi ose asgjësimi.

c) Shkelja e rregullave të sigurimit, të caktuara nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit, gjatë transportimit tranzit të mbetjeve e të lëndëve të rrezikshme.

ç) Mosdërgimi ose mosparaqitja në afat e të dhënave për gjendjen e mjedisit.

d) Mosshoqërimi i informacionit për gjendjen e mjedisit me rekomandimet për mënyrën e veprimit të shtetasve në rast parashikimi të pasojave negative për mjedisin.

dh) Mosinformim i popullsisë nga personat juridikë e fizikë për shkaktimin e ndotjes ose dëmtimit të mjedisit prej tyre, për masat e marra për kufizimin ose mënjanimin dhe për mënyrën e veprimit të shtetasve.

e) Mospajisja e blerësve ose konsumatorëve me informacionin përkatës për mallrat dhe shërbimet që janë të rrezikshme, dhe për efektet ose ndikimet negative të mundshme.

ë) Kundërshtimi ose shmangia e personave juridikë e fizikë për kryerjen e vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit.

f) Mosparaqitja e dokumentave të caktuara për fillimin e vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit.

g) Shkelja nga ekspertët e procedurës së vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit.

gj) Ushtrimi i veprimtarive ekonomike e sociale që mund të ndikojnë ndaj mjedisit pa lejen përkatëse të organeve kompetente shtetërore.

h) Shkelja e rregullave dhe udhëzimeve të caktuara nga Ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit për zona me mjedis veçanërisht të rrezikuar.

i) Shkelja e kufijve të lejueshëm të lëndëve ndotëse, të caktuara nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit.

j) Shkelja e rregullave për grumbullimin, depozitimin, ruajtjen, transportimin dhe sistemimin e mbetjeve e të lëndëve të rrezikshme, të caktuara nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit.

#### Neni 46

Për kundërvajtje administrative të parashikuara nga neni 45 i këtij ligji, jepen dënime me gjobë për personat fizikë nga 2000 deri në 50000 lekë dhe për personat juridikë nga 5000 deri në 50000 lekë. Krahas dënimit me gjobë mund të vendoset edhe marrja e mjeteve që shkaktojnë ndotjen dhe dëmtimin e mjedisit, ose heqja e lejeve të mjedisit.

Për persoant juridikë e fizikë të huaj që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjoba jepet në valutë të huaj në masat e mësipërme, të konvertuara me kursin e njoftuar nga Banka e Shqipërisë në ditën e konstatimit të kundërvajtjes.

#### Neni 47

Të drejtën e gjobës për kundërvajtjet administrative e kanë punonjësit e autorizuar nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit, punonjësit e Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit të autorizuar nga kryetari i Komitetit dhe inspektorët e inspektoriatit pranë këtij Komiteti dhe agjencie rajonale.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankimi, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose e njoftimit të tij, përkatësisht te ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së

Mjedisit, kryetari i Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe te kryeinspektori i Inspektoriatit për Mbrojtjen e Mjedisit, aktet e të cilëve janë të formës së prerë.

#### Neni 48

Gjoba derdhet në bankë për llogari të organeve, punonjësit e të cilave kanë dhënë dënime me gjobë, dhe likuidohet brenda 1 muaji nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë. Për çdo ditë-vonesë pas plotësimit të këtij afati deri në një muaj, gjoba shtohet 10 për qind mbi vleftën e saj.

Me kalimin e afateve të mësipërme, ekzekutimi i vendimit të dënimit me gjobë bëhet në

mënyrë të detyrueshme nëpërmjet bankës, ku ka llogarinë personi juridik e fizik, ose në bazë të ligjit për nxjerrjen e të ardhurave shtetërore, kur ata nuk kanë llogari në bankë.

#### Neni 49

Personat juridikë e fizikë, kundër vendimeve për mbylljen, ndalimin ose ndërprerjen e plotë a të pjesshme të veprimtarisë së tyre nga organet kompetente sipas neneve 15, 24 dhe 31 të këtij ligji, mund të bëjnë ankim në gjykatë brenda 15 ditëve nga data e dhënies së vendimit.

### KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 50

Të ardhurat nga tarifa e shërbimeve dhe gjobat që merren sipas këtij ligji, derdhen në llogarinë e organeve përkatëse për krijimin e fondeve të mjedisit.

Fondet e mjedisit përdoren si mbështetje financiare për këto veprimtari:

- a) Për marrjen e masave për mënjanimin e burimeve të ndotjes.
- b) Për hartimin e projekteve dhe marrjen e masave të riaftësimit në zonat ekologjikisht të dëmtuara.
- c) Për punë kërkimore-shkencore, kryerjen e studimeve të kualifikimit të kuadrit.
- ç) Pajisjen e zyrave dhe të personelit me mjetet e nevojshme.
- d) Për shpërblimin e punonjësve të mjedisit, ekspertëve dhe institucioneve të fushave përkatëse që kryejnë vlerësim të ndikimit ndaj mjedisit.
- dh) Për të përballuar shpenzimet administrative që lidhen me kontrollin, vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit, programet e monitorimit e të tjera të kësaj natyre.

#### Neni 51

Punonjësit e mbrojtjes së mjedisit, për kryerjen e detyrave sipas këtij ligji, bashkëpunojnë me organet e policisë së rendit dhe policisë pyjore, sipas një udhëzimi të veçantë që miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit, ministri i Rendit Publik dhe ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

#### Neni 52

Rregulla të hollësishme në zbatim të këtij ligji caktohen nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 53

Dekreti nr.5105, datë 30.10.1973 "Për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit", dekreti nr.7451, datë 5.1.1991 "Për disa ndryshime në dekretin nr.5105, datë 30.10.1973 "Për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit", dekreti nr.7452, datë 5.1.1991 "Për krijimin e Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

#### Neni 54

Ky ligj hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.447, datë 2.2.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha**